



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.1, datë 28.01.2021

**PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN
ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME
FONDE TË BUXHETIT VENDOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, të Udhëzimeve të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 3, 4 dhe 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike deri në 6%”, i ndryshuar, VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike si më poshtë vijon:
 - Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
 - Familja përpara se të përzgjidhet për t’u trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.

- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Rastet kur k/familjari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të buxhetit vendor të Bashkisë Durrës si më poshtë vijon:
- Familjet, të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Rastet kur k/familjari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
 - Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.
 - Familjet romë, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.
 - Familjet me një anëtar, që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
 - Familjet me kryefamiljare gra, të cilat kanë të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.
3. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 “Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.01.2021



BASHKIA DURRES
27.04.21 Nr. 706/P/16

2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 89 / prot.

Durrës, më 29 04 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 1 datë 28.01.2021 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

